

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: “Arhiko .ING” O.P. & N.SH. “GEO – MAP” me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	18.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: 16.06.2020, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: “Arhiko .ING” O.P. & N.SH. “GEO – MAP” me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: 623-20-1767-2-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-001-2-1-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: “Arhiko .ING” O.P. & N.SH. “GEO – MAP” me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: 623-20-1767-2-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-001-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: 11.06.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: 623-20-1767-2-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-001-2-1-1.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: “Arhiko .ING” O.P. & N.SH. “GEO – MAP” me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: 623-20-1767-2-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-001-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: 11.06.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 16.06.2020, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMORE NR 1.

Lidhur me pretendimin ankimor të Operatorit Ekonomik **ARHIKO.ING OP** se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me **Nenin 10 dhe Nenin 11 të LPP-së** sepse gjatë procesit të qasjes në dokumentet e Grupit të Operatorëve ekonomik fitues nuk ka garantuar transparencë duke e shpallë dokumentacionin e kompanisë fituese si dokument sekret afarist pa i përmbushur kushtet e parapara në këtë nen Autoriteti Kontraktues ka këtë Përgjigje:

Operatori Ekonomik ankues me datë 11.06.2020 ka kërkuar nga AK ti ofrojë qasje në dokumentet e ofertës së OE fitues. Autoriteti Kontraktues sipas nenit 10 të LPP-së i ka lejuar qasje të menjëhershme me datë 11.06.2020. Mirëpo Autoriteti Kontraktues me kërkesë të OE të rekomanduar për kontratë ka bërë një klasifikim të dokumenteve të ofertës së OE fitues në përputhje me nenin 11 paragrafi 3 të LPP-së, të cilat dokumente kanë të bëjnë me kërkesat e nenit 68 dhe 69 të LPP-së si (Lista e stafit teknik, listën e kontratave dhe referencave, diplomat, CV, Kontratat, listën e pajisjeve etj.) dhe në këto dokumente nuk ju ka dhënë qasja EO ankues. Qasja në këto dokumente nuk i është dhënë Grupit të operatorëve ekonomik ankues për shkak se Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues ka plotësuar kërkesën sipas Aneksit 3 të dosjes së tenderit dhe në këtë kërkesë është kërkuar që dokumentet e lartcekura të mbeten si dokument sekret afarist i kompanisë. Andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Ju sqarojmë se edhe OSHP në vendimet e saj e ka konstatuar një gjë të tillë, p.sh në vendimin nr. 349/19 të datës 06.08.2020 dhe në shumë vendime tjera.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMORE NR 2.

Lidhur me pretendimin ankimor të Operatorit Ekonomik **ARHIKO.ING OP** se Grupi i operatorëve ekonomik fitues nuk e ka plotësuar kërkesën 2 e kërkuar në pikën 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kërkesa 2

Lista e projekteve të kryera në lëmin e shërbimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar titujt e projekteve, shumën e kontratës, data e fillimit dhe data e mbarimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbalet e pranimi të shërbimeve.

Ju sqarojmë se edhe pas rishqyrtimit të dokumentacioneve lidhur me këtë kërkesë Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues e ka plotësuar këtë kërkesë konform dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Pra dy anëtarët e konzorciumit e kanë të plotësuar listën e projekteve të nënshkruar dhe vulosur dhe kanë të bashkangjitur kontratat dhe referencat si dhe vlera e projekteve të prezantuara e tejkalon shumën e cila ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj ky pretendim është i pabazuar dhe i pa mbështetur në ndonjë fakt apo dëshmi konkrete.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMORE NR 3.

Lidhur me pretendimin ankimor të Operatorit Ekonomik **ARHIKO.ING OP** se Grupi i operatorëve ekonomik fitues nuk i ka plotësuar dëshmitë në lidhje me stafin e kërkuar në pikën 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kërkesa 1 **Një Listë të Stafit profesional të nënshkruar dhe vulosur origjinal nga O.E**, ju sqarojmë se edhe pas rishqyrtimit të dokumentacioneve lidhur me këtë kërkesë konstatohet se Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues e ka plotësuar këtë kërkesë konform dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Ndërsa sa i përket stafit të angazhuar nga vendet tjera kjo nuk është ndonjë shkelje dhe mund të prezantohet nga cilido vend dhe AK konstaton se si në dosje të tenderit si në njoftimin për kontratë nuk është kërkuar nga asnjë OE që të marrin përsipër që të dorëzojnë një dokument në ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur tenderin. Pavarësisht nga kjo AK ka mundur në çdo moment kur e ka konsideruar të domosdoshëm apo kur e ka konsideruar një dokument jo të plotë ose të paqartë të kërkoj informata sqaruese nga secili OE pra edhe ndaj Grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë, por që në këtë situatë nuk e ka konsideruar të nevojshme për faktin se përmbajtja e dokumenteve sikurse ka vlerësuar AK është shumë e qartë duke i përmbajtur në vete gjitha elementet thelbësore dhe të domosdoshme. Për AK është e rëndësishme përmbajtja dhe qartësia e dokumentit sesa edhe forma e tyre. Andaj AK konstaton se ky pretendim është i pabazuar dhe si i tillë është hedhur poshtë.

Ne si autoritet kontraktues jemi të obliguar që ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin tenderëve ta bëjmë sipas kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe nuk mund të dalim jashtë këtyre kërkesave sepse atëherë do të vepronim në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së parashihet si në vijim *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*.

Duke u bazuar në kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, rezulton se Grupi i Operatorëve ekonomik fitues i ka plotësuar kërkesat e specifikuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit sa i përket kësaj kërkesë, dhe në këtë rezulton që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni të plotë me nenin 59 të LPP-së dhe duke u respektuar edhe të gjitha dispozitat e LPP-së, prandaj refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e OE ankues **“ARHIKO.ING OP”**.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit